

ÇLIRIM BIDOLLARI

MARTIN CAMAJ EDHE ONOMAST (Plotësim portreti)

Dy kanë qënë pikëpjekjet e M. Camajt me onomastikën, e para në vitin 1969, e pasqyruar në trajtën e një shkrimi të shkurtër në numrin XIII të revistës “Shêjzat” të atij viti dhe e bërë e njohur për ne përmes një bibliografie të veprave të M. Camajt, përgatitur prej studiuesit arbëresh Françesko Altimari dhe botuar në revistën Albanica nr. 2, kushtuar M. Camajt me titull “Gjurmë të popullsisë shqiptare në provincën e Piacenzës” dhe e dyta (pikëpjekje) në numrin vijues të Shêjzave XIV të vitit 1970 nën titullin “Sprovë për gjetjen e kriterëve në analizën e emnavet të vend-banimeve”, paraqitur në të njëjtën bibliografi të Françesko Altimarit.

Po i bëjmë objekt shqyrtimi këta dy artikuj shkencorë të autorit jubilar, për të vënë pllakëzën e fundit në mozaikun e portretit të shumanshëm krijues shkencor, që po ia skicon atij kjo Konferencë Shkencore.

Në shkrimin e parë, M. Camaj e paraqet si “një ndër detyrë kryesore të historianëve që merren me çashtje shqiptare sqarimin e valëve të ndryshme të dyndjeve të shqiptarëve drejt dheut të Italisë gjatë pushtimit turk” dhe me këtë formulim do të dukej se do të kishim të bënim me një artikull shkencor nga fusha e historisë, por përmbajtja e tij na dëshmon se autori shërbehet më shumë me mjete të onomastikës dhe posaçërisht të patronimisë, kur përpiqet të gjejë argumente për të provuar shqiptarësinë e atyre mërgimtarëve.

Siç e pohon vetë Camaj, koha e dyndjes mbetet “e pasqarueme, sidoqoftë shumë para shekullit XVII, sepse nuk shënohet në regjistrat e famullisë së Pievettas, përndryshe do t’u gjindte ndonjë shënim në lidhje me ngjarjen e ardhjes së një gjindje të re në atë trevë”.

Argumenti antropologjik: karakteristikat somatike, doket e zakonet, si dhe ndonjë gojëdhanë gjithashtu, pak ndihmojnë, për më tepër që janë dhënë nga një studiues italian Aldo Boreri që në vitin 1940 në një revistë lokale: “Këta banorë kanë kokë brakoçefale, fëtyrë të gjatë dhe sy të zez në trajtë bajame”, ndërsa banorët e Bosco Toscas kanë edhe dallime karakteriale me pievettasit, të tilla si karakterin e hapët të vetin dhe mbylljen në vetvete dhe difidencën e fqinjëve të parë të tyre (pievettasve).

“Ata dhe pasardhësit e tyre u muerrën me lundrim në lumin Po, tue fitue jetesën me peshkim dhe tregti druni (me shtymje trupash-jetesë e vështirë), ndërsa pievettasit në tanë rethinën janë të njoftun sot si punues këpucësh druni (zoccoli-nallane), ndërsa gratë bajshin në vekë shajakë e pëlhura, që i shitshin në katundet tjera”, kanë edhe disa ushqime e bestytini, të ndryshme krejt nga ato të italianëve.

Pasi konsumon edhe argumentin e gojëdhanës, e cila nuk sqaron ndonjë rrethanë të veçantë, sepse ndërsa pievettasit e pranojnë atë, pasi ajo ua njeh prejardhjen shqiptare, banorët e Bosco Toscas, siç shprehet autori, “e prapojnë një mundësi të tillë”.

Mbeten për t’u verifikuar argumentet gjuhësore-onomastike: “ndonjë mbetuni gjuhe, ndonjë toponim dhe më në fund ndonjë patronim, emër familjeje”, sepse, sipas Camajt “njerëzia shqiptare që mërgoi në Veri (të Italisë) u përnjisue shpejt me popullsinë e vendit, tue ruejtë aty-këtu vetëm mbiemna shqiptarë, që përkujtojnë rrjedhjen e tyre, si Albanese, Albanesi e sa tjerë”.

Ndryshe nga mërgimtarët shqiptarë në Italinë e Jugut, të cilët i ruajtën gjuhën, doket dhe, në përgjithësi, karakteristikat somatike të të parëve, për popullsinë shqiptare të Veriut “asht karakteristike stërpikja e tyre, tue mos ja dalë kurr të trajtojnë qendra apo ishuj etnikë mes gjindjes italiane, sikurse në Italinë e Jugut”. Por kjo rregull ka një përjashtim, pohon autori: “vetëm Pievetta, një katund në provincën e Piacenzës, ruen në tanësi kujtimin se janë të ardhun e se të parët e tyre kanë qenë shqiptarë, gjë që e përforcojnë edhe emrat e familjeve: Albanesi dhe ndoshta Mucchi, që nuk gjindet ngjeti në Provincë”.

Megjithatë, argument tjetër jo më pak bindës për Camajn është ai onomastik e posaçërisht toponimiku, emri i katundit Bosco Tosca. “Që Tosca të paraqesë ndonji popullsi tjetër ballkanike nuk ka të ngjam, shprehet ai, shumë-shum tue gjikue mbas skajit Tosca, *këtu kemi të bajmë me përfaqësuesit e dy fiseve të ndryshme shqiptare, që njëkohësisht erdhën e zunë vend në myset bregore të Po (lumi Po)*”.

Për të provuar shqiptarësinë e këtij katundi të dytë, përpos emrit të tij, Camaj i jep një peshë të veçantë rivalitetit mes dy katundeve, që ne do ta quanim një argument psikologjik-karakterial, që mund të ketë shpënë deri në pagëzimin e katundit me emrin *Bosco Tosca*, nga përfaqësues të një fisi tjetër shqiptar, që duhet të ketë qenë gegë, gjë krejt e rëndomtë me këtë tip toponimi, që quhet ekzonim, d.m.th. emërtim së jashtmi, prej të tjerësh.

Artikulli i dytë nuk ka nevojë për kurrfarë apologjie për të provuar natyrën e tij, por edhe karakterin profesional të tij, që ashtu siç e shpreh qartë që në titull autori ynë, e dëshmon edhe gjatë shtjellimit, ndonëse me

modesti thotë: “edhe unë (si Zef Valentini, mbi materialet e të cilit mbështetet - posaçërisht në artikullin e tij të gjatë me titull: Sviluppo Onomastico-toponomastici tribali delle comunità albanesi in Sicilia, botuar në: Bolletino del centro di studi Filologici e Linguistici Siciliani, Vol.III-1955) në këtë punim timin nuk qëllimoj të jap zgjidhje apo të baj zbulime befasuese, pa hy në çashtje tepër specifike sikurse asht zhvillimi fonetik i tyne”.

Pasi lë mënjanë, apo siç shprehet ai *manesh* “me qëllim emrat e katundeve dhe të vendbanimeve të vogla me përdhje nga emna vetorë (Bibaj, Lekaj, Vukaj), por edhe emnat e vendeve me kuptim të çeltë (të qartë) si Temali, Telumja etj.”, ai merr në shqyrtim disa “prej atyne emnave të vendbanimeve të vjetra dhe të dëshmuara në veprat e Valentinit e ngjeti, për trajtat e tyne të interesantshëm dhe në pikpamje gjuhësore”.

Emrat e vendbanimeve, që merren në shqyrtim janë: Drishti, Mesi, Mazreku, Bena (Benda), Gushta, Qerreti, Vila, Mëgulla (Mëngulla), Arra, Katundi, Lumardhi dhe me interpretimin e tyre autori është përgjithësisht në harmoni me etimologët e tjerë (Çabej, Valentini), por duke dhënë edhe ndonjë trajtim shtesë si te rasti i emërimit *Mazërek*<*Mazarak*, ku kundërshton Valentinin për lidhjen e tij me emërvendin *Messareti*, edhe fis shqiptar i krahinës së Ohrit, apo duke vënë në dyshim edhe ndonjë shpjegim etimologjik si te rasti i emërvendit *Arrë*, që, sipas tij nuk vjen nga shënimi i pemës *arr/ë-a*, por nga *arna*, shumësi i fjalës *ar/ë-a* “tokë e punueme” dhe së fundi edhe tek oikonimi *Lumardhi*, që, për mendimin e tij mund të shpjegohet me anën e shqipes dhe jo nga lum i madh, por nga parashtesa lë- lu- me një -n- epentike (si te *lëngo* prej *lig*) me këtë rend zhvillimi: *Lënbardh-Lunbardh-Lumbardh* (shndërrimi n>m para një buzoreje).

Prej analizës së këtyre emrave vendbanimesh shqiptare autori vjen në fushën e “çështjes tepër të kapërthyeme të fiseve e të lëvizjeve të tyne, si të zogjve shtektarë”, siç e quan ai dhe merr shkas nga kjo të paraqesë për shqyrtim disa kritere. Po cilët janë këta kritere?

Emri i një fisi apo vëllazënie mund të marrë dhe funksionin e shënimit të vendit: *Berisha* shenjon fisin e vendin e banuar prej tij, por mund të ndodhë edhe e kundërta: një fis mund të ngulë në një vend e me kohë të marrë emrin e vendbanimit të vjetër (banorët me mbiemrin *Thaçi* në katundin *Arrë*), por të shpërngulur nga *Arra* në *Dibër* mund të kenë humbur gojëdhanën se ata janë të fisit *Thaçi*, por mbajnë mend se janë të dyndur prej *Arrës* e ta quajnë veten “fisi i *Arrës*” me të njëjtën vlerë kuptimore si “fisi i *Berishës*”.

Një vëllazni që më vonë mund të zhvillohet në fis a) mund të marrë emrin e mbiemrin e të parit: *Marlekaj* (nga Mark *Leka*), b) mund të emërtohet me një apelativ shenjues të vendit simbas pikëqëndrimit të fqinjëve: *Matanash*, *Telumja*, *Temali*, c) nga zeja ushtruese e fisit: *Lopës*, *Mazarekë*, *Berishë*, etj. por edhe *Dalmates-Delmates*, nëse ky emër përkon me të vërtetë me fjalën *dele*.

Midis popujve indoeuropianë, por edhe jashtë kësaj familjeje, fiset i kanë marrë emrat nga skajet shenjuese të ngjyrës: *Bardhaj*, *Kuçi* e ndoshta edhe *Krasniqe*, ndonëse ky rasti i fundit për ne mbetet për t'u diskutuar. "Vëllaznitë arumune në Maqedoni kanë pasur emra ngjyrash, sepse mbanin dhen të një ngjyre: të bardha ose të zeza, për t'i ndarë më lehtë tubat, që në kullosa mund të përziheshin. Gjegjësisht edhe teshat e leshta të vëllaznive kishin po atë ngjyrë të dhenve".

Në fund Camaj tërheq vëmendjen e studiuesve onomastë edhe tek historia dhe gojëdhana, por sidomos te "dija mbi fonetikën historike e edhe te fjalëtrajtimi e semantika, të cilat mund të na hapin rrugë të reja në kthjellimin e emrave të vendeve e të fiseve".

Këto kritere janë sa të përgjithshme aq edhe të veçanta për shqipen, që mesa kuptohet nga mënyra e formulimit, janë të menduara thellë mbi një lëndë konkrete të shqipes e jo të marra nga literatura e huaj. Vetë Camaj, kur flet për veten te *Palimpsest* është shndërruar në onomaturg, kur ka thënë: 'Kam lindë në një vis të egër *ku s'ka shkelë kamba e kalit*', duke na dhënë një denominues perifrastik. Kështu iu desh të punojë këtij mjeshtri të shqipes, që siç thotë vetë te "Letër mbi stilin" dërguar Idriz Lamajt, "qënia malësor s'ndahet meje", sepse atij iu desh të mësonte më parë latinishten, sesa gjuhën e gjarpnit.

BIBLIOGRAFI

- Altimari, F., *Profilo bio-bibliografico di Martin Camaj*, in "Albanica", Number 2, Spring 1991, pp. 10-22
- Camaj. M., *Palimpsest (Foreword)*. in "Albanica", Number 1, Winter 1990, pp. 90-93.
- Camaj. M., *Il contributo degli italo-albanesi alla cultura europea*. In "Albanica", Number 3-4, Winter 1992, pp. 45-49.
- Camaj, M., *Letter on his style* (to Idriz Lamaj). München, 22.8.1989, in "Albanica", Number 3-4, Winter 1992, pp. 171-174.
- Çabej, E., *Çështja e prejardhjes së ngulimevet arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave të vendeve*, në "Studime

filologjike” nr. 2, 1972, f. 23-34. Kumtesë e mbajtur në Kongresin VIII ndërkombëtar të studimeve onomastike në Amsterdam, 28 gusht 1963 dhe botuar së pari gjermanisht në “Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences”, The Hague-Paris 1966, pp. 70-81.

Schuflay, M., *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*, Wien 1924, f. 26.

Valentini, G., *Sviluppi Onomastico-toponomastici tribali delle comunità albanesi in Sicilia*. in: Bolletino del Centro di Studi Fililogici e Linguistici Siciliani. Vol. III, 1955.

